



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ



**KUVENDI I KOMUNËS SË PEJES**

**I.Numër: 060/01 - 6823, datë: 31. Janar 2019.**

Në bazë të nenit 11, nenit 12. 2.pika d) dhe nenit 24.1.të Ligjit Nr.03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28.datë: 04.qershor 2008”), nenit 8, dhe nenit 9 paragrafi 1.pika d) të Statutit të Komunës së Pejës, 01.Numër: 09 – 8103 dt. 29.shtator 2008, në propozim të kryetarit të Komunës dhe rekomandim të Komitetit për Politikë e Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 31.Janar 2019, muarr:

**V E N D I M**  
**Nr.06/2019**

**Mbi caktimin e kompenzimit-meditjeve për takim pune të anëtarëve të komisionit për zgjedhjen e Këshillave lokale në Komunën e Pejës.**

1.Me këtë vendim, caktohet meditja në shumë prej 20,00 € për çdo takim pune (punë shtesë), jashtë orarit të punës, për anëtarë të Komisionit Komunal për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për zgjedhjen e Këshillave lokale në Komunën e Pejës dhe stafit mbështetës të tij, sipas Kalendarit të takimeve të mbajtura për periudhën zgjedhore 01.10.2018 gjer me 29.11.2018.

2.Kompenzimi nga pika 1 e këtij vendimi, do tu ipet anëtarëve të Komisionit të zgjedhur me Vendimin Nr.40/2018, I.Numër:01-112/01-66956 dt.29.Qershor 2018 të Kuvendit Komunal Pejë, si dhe stafit mbështetës (logjistika 2 persona).

3.Kompenzimi i meditjeve do të bëhet nga buxheti Komunal - Kodi për mallra dhe shërbime - Drejtoria e Administratës së KK.Pejë.

4.Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës, në bashkëpunim me drejtorin për Buxhet e Financa, dhe drejtorinë për Administratë të KK.Pejë.

5. Ky vendim hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës së Pejës.

**Vendimi ti dërgohet:**

- 1x1.Kryetarit të Komunës
- 1x1.DBF.- DA.-të
- 1x1.Arkivë.



**KRYESUESI I KUVENDIT ,**  
**Dr. Islam Husaj**